

**Konferenca e I<sup>rë</sup> Vendore e Odës së Infermierëve,  
Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të  
Kosovës**

**Ferizaj Kosovë, 4 – 5 Maj 2019**

**“NDEROJMË TË KALUARËN –  
NDËRTOJMË TË ARDHMEN”**

***Libri i abstrakteve***



Prishtinë, Maj 2019

Adresa: Rruga “Holger Petersen” 10000 Prishtinë  
Botuesi: Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë  
shëndetësor – OIK

ISBN: 978-9951-8984-0-9



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*



**Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës**  
**Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova**  
**Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals**

---

**Konferenca e I<sup>re</sup> Vendore e Odës së Infermierëve të**  
**Kosovës**  
**Ferizaj Kosovë, 4 – 5 Maj 2019**

**“NDEROJMË TË KALUARËN – NDËRTOJMË TË**  
**ARDHMEN”**

***Libri i abstrakteve***

***Këshilli udhëheqës***

Naser Rrustemaj – Kryetar i Konferencës

Fetije Huruglica

Idriz Sopjani

Naime Brajshori

Hysni Bajrami

***Këshilli shkencor***

Naim Jerliu

Natyra Karahoda

Afërdita Mustafa

Bashkim Hyseni

Fekrije Hasani

Hanife Hoxha

Lirije Beqiri

Muharrem Arifi

Shqipe Tahiri

Xhemajl Dugolli

## *Këshilli Organizativ*

Xhemajl Dugolli – kryetar

Muharrem Arifi

Ismet Jashari

Lirije Beqiri

Shpejtim Rramanaj

Sami Thaçi

Feim Hasani

Bashkim Mehmeti

Rexhep Jakaj

Musë Baftiu

Fetije Huruglica

Behrije Halilaj-Vishi

Besnike Kolgeci

Genc Bajraktari

*Sekretariati i Konferencës*

Genc Bajraktari – udhëheqës

Besian Hajrizi

Dafina Bahtiri

*Anëtarët e Nderit*

Sami Gashi

Shyqri Mehmeti

Elmaze Azizi

Habibe Jakupi

Bahrije Xhelili

## **Mirësevini**

Kemi kënaqësinë të ju mirëpresim në Konferencën e I<sup>të</sup> Rajonale të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësor me temën “Nderojmë të kaluarën – Ndërtojmë të ardhmen”

Qëllimi i Konferencës së Parë është që të forcohet roli i Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësor në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, promovimin dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës në Republikën e Kosovës.

Programi i Konferencës është dizajnuar me prezantimin e punimeve në sesionet e përacktuara dhe sesionet e poster prezantimeve para pjesëmarrësve në konferencë.

Punimet në këtë konferencë mbulojnë fushat kryesore të infermierisë duke filluar nga përshkrimi i ecurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kohën e luftës, sëmundjet ngjitëse dhe jongjitëse, punime për satisfaksionin e pacientëve me shërbimet shëndetësore dhe punime të tjera.

Kjo është mundësi e mirë për takim dhe shkëmbim të përvojave në mesin e Infermierëve që ofrojnë shërbime shëndetësore nga vende të ndryshme të Kosovës.

Ju falenderojmë për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në këtë konferencë.

Sinqerisht

**Naser Rrustemaj**

*Kryetar i OIK*



## **AGJENDA E KONFERENCËS**

**4 – 5 Maj 2019 Ferizaj**

### **Dita e I-rë e Konferencës**

08:00 – 09:45	Regjistrimi
10:00 – 11:00	Hapja e Konferencës – Himni Kombëtar dhe Himni i Kosovës, 1 minut heshtje Koreografi Ansambli Kastriotët Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të OIK-ut Fjalë përshëndetëse e Presidentit Fjalë përshëndetëse e Kryeparlamentari Fjalë përshëndetëse e Kryeministrit Fjalë përshëndetëse e Ministrit të Shëndetësisë Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të Komunës së Ferizajit Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të Komunës së Shtimes Fjalë përshëndetëse e një nga mjekët e luftës Roli i Infermierit në luftë – Musë Baftiu Video dokumentar – Rexhep Jakaj
11:00 – 11:30	Pauzë kafe
11:30 – 11:40	Vlerat profesionale ne Infermieri – Abdulla Gruda
11:40 – 11:50	Diabeti – Shukrije Baruti
11:50 – 12:00	Vlerësimi i shërbimeve shëndetësore në dializën e parë nga perspektiva e pacientëve – Fatmire Ahmeti

12:00 – 12:10	Diskutim
12:10 – 13:30	Dreka
13:30 – 13:40	Gjendja e shërbimit të kujdesit paliativ në Kosovë – Shahadije Raka
13:40 – 13:50	Kujdesi shtëpiak tek pacientët e pa lëvizshëm në kujdesin parësor shëndetësor në Ferizaj – Selim Bega
13:50 – 14:00	Njohuritë mbi efektet e dëmshme të pirjes aktive dhe pasive të duhanit tek adoleshentet – Rukije Hajdari – Pllana
14:00 – 14:15	Roli i Infermierit gjatë luftës në Kosovë – Resmije Saipi
14:15 – 14:20	Diskutim
14:20 – 14:50	Pauze kafe
14:50 – 15:00	Shkalla e depresionit postpartal dhe kënaqësia martesore në Kosovë – Vjollca Isufi
15:00 – 15:10	Vlerësimi i njohurive të prindërve, edukatorëve dhe mësimdhënësve në shkolla për faktorët e rrezikut nga sëmundjet ngjitëse në Komunën e Ferizajit – Mimoza Emini
15:10 – 15:20	Kënaqshmëria e pacientëve me shërbimin infermieror në departamentin internistik Gjilan – Feride Morina
15:20 – 15:30	Diskutim
15:30 – 16:00	Diskutim dhe përmbyllja e ditës së parë të Konferencës

## **Dita e II-të e Konferencës**

---

08:00 – 09:00	Regjistrimi (Kafe)
09:00 – 09:10	Ndikimi i obezitetit në sëmundjet kardiovaskulare – Shpejtim Rramanaj
09:10 – 09:20	Roli i Infermierit gjatë luftës në Dukagjin – Hidajete Krasniqi
09:20 – 09:30	Diskutim
09:30 – 09:40	Konkluzione dhe rekomandime
09:40 – 09:50	Shpërndarja e Certifikatave
09:50 – 10:00	Nisja për vizitë në ish Spitalin ushtarak të Zonës së Nerodimes
12:00	Kamping dhe dreka për pjesëmarrësit në malet e Llanishtës

## **Përmbajtja**

### **INFERMIERIA DHE LUFTA ÇLIRIMTARE**

Roli i Infermierisë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Komunën e Shtimes dhe Ferizajt .....	13
Roli i Infermierisë gjatë luftës në Dukagjin .....	20
Roli i infermierisë gjatë luftës në Kosovë dhe periudha pas luftës ..	24

### **ABSTRAKTET E PUNIMEVE**

Mos zbatimi i rekomandimeve të modifikimit të jetesës në mesin e pacientëve me Diabet Melitus Tip 2 .....	30
Ndikimi i obezitetit në sëmundjet kardiovaskulare .....	32
Ofrimi i kujdesit paliativ nga Kujdesi primar dhe atij terciar .....	34
Njohurit mbi efektet e dëmshme të pirjes aktive dhe pasive të duhanit tek Adoleshentët .....	36
Kënaqshmëria e pacientëve me shërbimin infermieror në departamentin internistik Gjilan .....	38
Cilësia e shërbimeve tek pacientët në Repartin e Hemodializës në QKUK .....	40
Shkalla e depresionit postpartal dhe kënaqësia martesore në Kosovë .....	42
Vlerat profesionale në Infermieri .....	44
Kujdesi shtëpiak te pacientët e palëvizëshëm në kujdesin parësor shëndetësor në Ferizaj .....	46
Vlerësimi i njohurive të prindërve, edukatorëve dhe mësimdhënësve në shkolla për faktorët e rrezikut nga sëmundjet ngjitëse .....	50

**LISTA E AUTORËVE**

*Infermiera*  
*dhe lufta Çlirimtare*

## **Roli i Infermierisë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Komunën e Shtimes dhe Ferizajt**

Musë Baftiu, Ali Shaqiri, Xhemajl Dugolli

Kaluan 20 vite dhe temat për luftën akoma zgjojnë emocione të mëdha.

Pas daljes publike të UÇK-së, luftës dhe sakrificës së komandantit legjendar Adem Jasharit dhe familjes së tij, në Marsin e vitit 1998, radhët e UÇK-së po shtoheshin dita ditës e bashkë me ta edhe zgjerimi i territoreve të lira. Krahas shtimit dhe zgjerimit të këtyre aktiviteteve ushtarake, lindi nevoja urgjente e zhvillimit të logjistikës ku bënte pjesë edhe shërbimi shëndetësor, në mënyrë që të plagosurit të trajtoheshin shpejt dhe profesionalisht, si dhe popullata në këto zona të merrte trajtimin e duhur dhe shërbimet e domosdoshme shëndetësore.

Organizimi i sektorit shëndetësor ushtarak të UÇK-së ishte vullnetar ashtu siq ishte edhe vetë lufta e saj. Bashkë me krismat e para të ushtarëve të lirisë, u mobilizuan edhe “Engjujt e bardhë” infermierët, të cilët duke mos menduar për jetën e tyre, dëshmuar çka do të thotë të jesh njeri, humanist e mbi të gjitha atëdhedashës. Pra me tu dëgjuar jehona e kësaj lufte për çlirim dhe kthim të dinjitetit të nëpërkëmbur. i'u përgjigjën këtij kushtimi pa hezitur, në asnjë çast, duke grumbulluar ato pak vegla pune e mjete të ndryshme sanitare dhe u

vunë në dispozicion për të ndihmuar vijën e frontit. Jeta e një infermieri ishte e rrezikuar njëjtë sikur e të gjithë luftëtarëve e ndoshta edhe më shumë. Reagimi i infermierit në trajtimin e plagëve, dhënjën e ndihmës së parë në vijat e frontit dhe tërheqja e të plagosurve rezultoi me një numër infermierësh të plagosur, për fat të keq disa edhe u vranë duke kryer detyrën më njerëzore etike për të ofruar ndihmë për luftëtarët e lirisë. Këtu do të përmendim Infermierët dëshmorë të rënë në Zonën Operative të Nerodimës, si: Emsale Frangu, Jehona Raka, Lumnije Raka dhe Imri Halili – student i Fakultetit të Mjekësisë.

Qëllimi i këtij punimi është të paraqitet roli dhe kontributi i infermierëve gjatë luftës në Komunën e Shtimes dhe Ferizajt, të cilat sipas organizimit ushtarak të UÇK-së, shtriheshin në dy zona, Zona Operative e Nerodimes dhe ajo e Pashtrikut.

Ky punim ka karakter narrativ, deskriptiv, historik dhe përmban të dhëna kronologjike dhe statistikore rreth: Organizimit të sektorit shëndetësorë ushtarak të UÇK-së në këto zona, Statistikave të shërbimeve shëndetësore, fotografi dhe materiale tjera faktografike nga e gjithë periudha e luftës.

Punimi u realizua duke shfrytëzuar ditarët e punës dhe foto-materialet e kohës, origjinale për nga burimi, duke shpalosur kujtesën individuale dhe intervistuar akterët e gjallë të ngjarjeve të cilët gdhendën historinë tonë të lavdishme.

Përmes këtij punimi synojmë të prezentojmë në mënyrë kronologjike organizimin dhe aktivitetet e personelit shëndetësor në këto dy komuna të cilat edhe pse në territor jo të madh, por shumë të rëndësishëm në aspektin gjeostrategjik në Grykën e Carralevës,

përgjatë magjistrales Shtime - Prizren, e cila i ndan këto dy zona. Ky territor ishte shumë i rëndësishëm edhe në aspektin e logjistikës, si arterie apo rrugë lidhëse e zonave të UÇK-së për rekrutimin e ushtarëve të rinj, furnizim me ushqim, armatim, barëra, pastaj pozicionimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së si dhe dy medimeve të vetme publike të organizuara nga vetë radhët e ushtarëve, Radio Kosova e Lirë dhe Kosova Press, të cilat u bënë zë i lirisë.

Për organizimin e stacionarit të parë ushtarak në Komunën e Shtimes, ishin bërë përgatitje paraprake në konspiracion të thellë në mes njerëzve të cilët kishin shprehur gadishmërinë për të përkrahur luftën. Gjithçka kishte filluar në Ambulancën e Sh.H.B. “Nëna Terezë” në Shtime nga ku ishin marrur materialet e para sanitare, instrumentet kirurgjike dhe disa nga stafi i cili ishte punësuar aty, mjek e infermierë e që kishin shprehur gadishmërinë për t’iu përgjigjur kushtrimit të lirisë dhe rreshtimit në radhët e UÇK-së.

Beteja në Grykën e Carralevës me datë 14.06.1998, plagosja e ushtarëve dhe gjendja e krijuar në këtë hapsirë, pa kujdes shëndetësor, shtuan urgjentisht hapjen e këtij stacionari dhe kështu më datë 16.06.1998 filloi punën stacionari i parë shëndetësor i UÇK-së në Komunën e Shtimes, në fshatin Pjetërshticë, në objektin e ambulancës së fshatit, në përbërje nga një mjek, një stomatolog, një laborant dhe pesë infermierë. Ky stacionar ishte si pikë rekrutimi për personelin shëndetësor, mjekë e infermierë nga komuna e Shtimes, Ferizajit, Lipjanit e më gjerë. Dhe nga këtu, u nisën dhe filluan shërbimin shëndetësorë në stacionarët tjerë në Shalë, Parkun e Blinajës, Bllacë, e në vende të tjera. Pas ofenzivës së ashpër serbe, të



Korrikut 2018, stacionari zhvendoset në grykat e maleve të Krojmirit dhe vazhdon punën profesionale e me përkushtim deri në çlirimin definitiv të vendit.

Ekipi shëndetësor i këtij stacionari, gjatë kësaj periudhe, sipas ditarëve të punës, ofroi 13,970 vizita mjekësore, mbi 45,000 shërbime infermierore, 3,493 shërbime të shëndetit oral dhe 120 lindje.

Infermierët gjatë kësaj periudhe, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në trajtimin e ushtarëve të plagosur, trajtimin e popullatës civile, si fëmijë, gra, e të moshuar. Këtu janë mjekuar plagët e dëshmorit të parë të komunës së Shtimes e shumë dëshmorëve tjerë, është bërë edhe amputimi i këmbës pa narkozë me sharrë dore, për prerjen e metalit, si paisje “kirurgjike”, ndërhyrje kjo e cila kaloi mirë dhe pa komplikime, asistuan gjatë procesit të lindjes për ardhjen në jetë të 120 foshnjave të reja dhe shërbime të shëndetit oral, si nxjerrje dhe mjekime të dhëmbëve.

Roli i infermierit në preventivë u dëshmuar gjatë vaksinimit të ushtarëve të Brigadës 121 “Komandant Kumanova” dhe Brigadës 123, me vaksinë kundër tetanusit, në Dhjetor të vitit 1998 dhe në Janar të vitit 1999, në bashkëpunim me ekipin e stacionarit të Shalës.

Në fund të Majit të vitit 1999, ky ekip sidomos infermierët në fushë të hapur në luginën e Krojmirit, iu ofron shërbime shëndetësore më se 100 të plagosurve të spitalit të Zonës Operative të Pashtrikut dhe të Drenicës, të cilët po transferoheshin në spitalin ushtarak të Zonës Operative të Neredimes për shkak të ofensivës shumë të ashpër serbe në këto zona.

Nga të gjitha këto shërbime të orfuara dhe shumë raste të tjera të veçanta e të pa përmendura që iu ofruan luftëtarëve, fëmijëve, grave e

të moshuarëve, por edhe të gjitha atyre që kishin nevojë, dëshmohet përkushtimi i infermierëve dhe roli i shumfishtë i tyre në ofrimin e kujdesit mjekësor aq të nevojshëm në këtë kohë e në këtë hapësirë.

Ekipi shëndetësor i stacionarit në Petrovë, gjatë periudhës nga muaji Korrik i vitit 1998 e deri në fund të luftës me 16 Qershor 1999, qëndroi në këtë zonë në shërbim të ushtarëve dhe popullit, përkundër vështirësive dhe peripecive shumë të rënda, duke ofruar shërbime shëndetësore të dëshmuara në ditarët e punës ku janë ofruar rreth 3,419 vizita mjekësore dhe mbi 10,000 shërbime të tjera infermierore, në veçanti edhe trajtimi i 71 të plagosurve në luftë.

Nuk mund të flitet për këtë temë e të mos përmendet roli i infermierisë edhe në rastin e ngjarjes makabre të njohur si Masakra e Reçakut, me ç`rast ishin vrarë e maskaruar mëse 45 civil të këtij fshati, ku mjeku dhe infermierët tanë të stacionarit në Petrovë, përveç punës profesionale, bënë edhe punën e ekspertëve të forenzikës mjekësore duke konstatuar plagët e masakrimit dhe duke i ilustruar dhe dokumentuar me foto-materiale.

Stacionari i parë shëndetësor ushtarak në Komunën e Ferizajit, komunë e cila i përkiste Zonës Operative të Neredimes, fillon së funksionuari nga data 27.07.1998 në fshatin Jezerc, ku kishte mjek të rregullt nga Ferizaj. Roli i infermierëve ishte shumë i rëndësishëm në këtë pikë të furnizuar mjaft mirë me material sanitar. Infermierët e këtij stacionari bashkë me mjekun, ishin gjithmonë në nivel të detyrës, ku gjatë ofensivës ushtarake serbe të Shtatorit të vitit 1998 e cila njihet si Epopeja e Jezercit, ofenzivë kjo e tmerrshme që la pas shumë të plagosur dhe 9 dëshmorë. Vlen të përmendet kujdesi

mjekësor ndaj ushtarit, i cili kishte 13 plagë në trup të shkatuara nga armët e zjarrit.

Me përfundimin e kësaj ofenzive, dukej se kjo zonë u shpërbë, por ndodhi e kundërta, kjo zonë shpejt u organizua në sektorin ushtarak në tre Brigada të cilat operonin nga Gryka e Carralevës në komunën e Shtimes, territori i Komunës së Ferizajit, Kaçanikut e deri te Hani i Elezit.

Në përputhje me këtë organizim, u bë edhe shpërndarja e personelit mjekësor e infermieror në stacionarë tjerë në këtë zonë siq ishte ai në fshatin Petrovë, Jezerc, Rancë, Pleshinë, e gjithashtu edhe në komunën e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit.

Zëri i arsyes nuk na jep komoditetin e bollshëm të mos përmendim kontributin e pa krahasueshëm me moshatarët e tyre në botën e civilizuar edhe të personelit shkollor mjekësor, që shumë nga infermierët ishin akoma të njomë nga mosha, ende ishin nxënës të infermierisë, e studentë të Mjekësisë, kur u përballën me punën e së ardhmes që kishin zgjedhur, me plagët e luftës, me mbledhjen e gjymtyrëve të trupave të të masakruarëve, por që duhej të adaptoheshin me erën e gjakut që derdhej kudo në fushëbeteja.

Organizimi i këtij sektori në këtë zonë kulmon me themelimin e Spitalit Ushtarak në fshatin Mollopolc të Shtimes, në fund të Marsit të vitit 1999, i cili gjatë ofenzivës serbe, u zhvendos fillimisht në fshatin Devetak, në Grykën e Topillës në Shpellën e Lakuriqëve, në Rancë pastaj kthimi në Mollopolc dhe në fund të luftës me datën 15.06.1999 në Spitalin Rajonal në Ferizaj. Datat 15 dhe 16 Qershor 1999, shënojnë kthimin triumfal të punëtorëve shëndetësor në

institucionet shtetërore të këtyre dy komunave, që deri në atë kohë ishin në flakët e luftës.

Ky spital kishte aktivitete të mëdha dhe të gjëra si vizita specialistike, trajtime kirurgjike, lindje e shërbime tjera. Ishte mirë i paisur me sallë operative, barna dhe materiale sanitare. Këtu u dha një kontribut i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve profesionale shëndetësore jo vetëm për ushtarët e popullatën e kësaj zone, por edhe më gjerë. Vlen të përmendim pranimin e menjëhershëm e mbi 100 të plagosurve nga zonat e Drenicës dhe Pashtrikut në fund të Majit të vitit 1999 për të cilët personeli shëndetësorë u kujdes deri në shërimin e plotë të tyre.

Roli i infermierit në luftën tonë ishte shumëdimensional dhe nuk ishte i fokusuar vetëm ofrimin e shërbimeve në përkujdesjen infermierore, por edhe për mendjen e shpirtin e të plagosurve. Shpesh këta infermierë përjetonin emocione të fuqishme, sepse ata qëndruan gjatë rreziqeve të përgjithshme si bashkësi, duke ndarë të mirën e të keqen, duke fjetur në spital, ndanë shtratin së bashku, të gjithë ishin një, ata panë djem të rinj që ishin të brezit të tyre, të cilët mbetën pa pjesët e trupit, pa familje, ata ua mbyllën sytë për herë fundit shumë dëshmorëve e martirëve të kombit. Ata askush nuk i kishte përgaditur për luftë.

Një nga shumë thënjet për infermierët, e që i shkon vërtetë shumë, thotë: “Shpëto një jetë dhe bëhesh hero, shpëto shumë dhe bëhesh infermier” E arritura më e madhe e këtij punimi është kthimi në vendin e ngjarjes me kujtesën tonë dhe ofrimi i dëshmive të një pune kolosale të zhvilluar në kushte ekstreme të rënda, por e realizuar me vullnet të pamposhtur nga i gjithë personeli shëndetësor e në veçanti

nga infermierët. Numri i infermierëve të luftë në këto dy zona ishte rreth 60 të tillë.

Trajtimi i kësaj teme synon mbajtjen e freskët të kujtesës përmes porosisë “Mos të harrojmë vitet 1998-1999”.

**Fjalet kyçe:** UÇK, infermier, luftë, shëndetësi, spital ushtarak, stacionar

## **Roli i Infermierisë gjatë luftës në Dukagjin**

Hidajete Krasniqi

Të gjithë nga ne, që sot kemi mbi 20 vjet jetë, kishim fatin e keq, që të përjetojmë luftën. Luftën, ku një popull përballej me një shtet, me synimin, shumë në detaje të artikuluar, për të çrrënjësuar një popull të tërë nga vendi i vet. Duke qenë ky qëllimi i tyre, shteti serb nuk bëri asnjë dallim - goditi çdo gjë dhe çdo kënd.

Në rrethana të tilla mbijetesa imponohej, vetvetiu si kryegjësja e të gjitha gjërave.

Rrjedhimisht edhe shëndetësia. Fillimisht duhej ringjallur, ngase deri në vitet 1990 ajo më veq ishte gjunjësuar.

Qëllimi i këtij punimi është të pasqyroj, të përmbledhur, aktivitetin e profesionistëve shëndetësor në komunën e Pejës, mjekëve, specifikisht infermierëve duke potencuar angazhimin e tyre që kujdesit shëndetësor të popullatës ti qaseshin si një mekanizëm i strukturuar, organizuar dhe i adaptueshëm në rrethanat specifike që mbretëruan – paralufta dhe lufta, për të ardhur në përfundimin se një qasje e tillë ka rezultuar me ngritjen e një strukture paralele shëndetësore që ka arritur në njërin anë të mobilizoj dhe maksimizoj

kontributin e profesionistëve shëndetësor, e posaçërisht mjekëve dhe infermierëve të regjioneve dhe, në anën tjetër, të siguroj një përkujdesje shëndetësore çoftë për popullatën, çoftë për luftëtarët e UÇK-së.

Punimi nuk kishte për qëllim pasqyrimin e aktivitetit të asnjë individi në vete, andaj edhe nuk përmban emra, por duhet të theksohet qëllimi thelbësor për të treguar karakterin e strukturuar dhe organizuar të veprimtarisë së individëve përbrenda sistemit.

**Metodologjia** e përdorur në studim është bazuar mbi hulumtimin aplikativ dhe që është bazuar në njohjen historike, njohjen empirike, deskripcionin si metodë, me motivim për kërkim shkencor - pasqyrimi i së vërtetës.

Udhërrëfyes thënia e Aristotelit “Motivim i kërkimit shkencor është e vërteta” andaj materialet e përdorura janë: dokumentet e shkruara - procesverbale, dokumente historike si dosje dhe libra protokolli, ditarë personal, kujtesa historike përmes intervistimit të pjesëmarrësve edhe pacientëve.

**Rezultatet** nga hulumtimi por edhe njohja historike nga përvoja personale, duke qenë aktere gjatë gjithë kohës, rezulton se në vitin 1991, si rezultat i një organizimi të ngritur nën emërtimin “Kolegjiumi i Pavarur i Mjekëve të Mjekësisë së Përgjithshme në Pejë” u ngrit institucioni i parë shëndetësor me emërtimin “Medicus”, emërtim ky për përdorim para organeve të pushtetit serb, ndërsa “Dr. Rifat Frashëri” ishte emërtimi i brendshëm. Ishim të anagzhuar katër mjekë dhe tetë infermierë. Nga ky insitucion, si rrjetizim krijohen ambulanta shëndetësore në Baran, Nepole, Radavc, ambaluntat shkollore në Pejë, Rraushiq, Radac, Ozdrim, Tërstenik,

për tu shtrirë në gjithsej 23 ambulanta. I tërë ky rrjet institucionesh, me fillimin e luftës së armatosur, u vunë nën shërbim të UÇK-së. Numri i infermierëve të angazhuar ishte rreth 50 nga to 40 femra dhe janë realizuar mbi 100,000 vizita mjekësore.

Janë realizuar vizita sistematike të nxënësve nëpër shkolla, vizita shtëpiake për të moshuarit dhe për ata të pa lëvizshëm.

Në vitin 1995, u hapë Ambulanta "Nëna Terezë" në të gjithë rrëgjoni e Dukagjinit, jo vetëm në qytete por edhe në fshatra, rreth 50 infermierë të këtij regjioni u angazhuan për punë në këto ambulanta që të gjitha shërbimet, kryheshin falas dhe punëtorët shëndetësor punonin pa kompensim material, vetëm e vetëm që t'i ndihmonin popullatës.

Pas 24 Marsit të vitit 1998, ku në Dukagjin shpërthen lufta, infermierët ishin ata që nëpër shtëpi trajtuan të plagosurit por edhe civilët, sepse popullata ishte e zhvendosur prej një fshati në një tjetër fshat dhe nevoja për ndihmë ishte shumë e madhe dhe kërkesat ishin shumë të mëdha për kujdes shëndetësor. Përkujdesja shëndetësore asnjëherë nuk ka munguar, terapia e nevojshme u siguronte duke ju falënderuar "Mjekët pa Kufi" dhe "UNHCR" që vazhdimisht kanë furnizuar me terapinë e nevojshme, si me terapi tabletare, ampullare, infuzione dhe mjete të nevojshme për pastrim plage që ishte nevoja më e madhe.

Një numër jo i madh i infermiereve u kyçën në UÇK në Spitalet Ushtarake. Spitali Ushtarak në Jerznik, pastaj në Kryshec, në Zhabel, Kaliqan dhe i fundit në Maznik. Spitalet u zhvendoseshin varësisht prej luftimeve dhe roli i infermierit në luftë tejkalonte ato që kishin mësuar në shkollë, duhej të ishin edhe mjek kirurg, psikiatër, psikolog, gjellëbërëse, pastruese e, edhe luftëtare.

Në vitin 1999, në Qershor, të dalur nga lufta, por të lodhur e të lënduar, me humbje edhe në kolegë por edhe të aftë për të filluar rimëkëmbjen e shëndetësisë.

**Konkluzionet** na rezultuan se në regjionin objekt studimi – Komuna e Pejës, ishte ngritur një sistem i strukturuar dhe organizuar shëndetësor mjaft efikas për rrethanat.

Kishte angazhim maksimal të profesionistëve shëndetësor, specifikisht infermierëve në këtë sistem. Angazhimi i infermiereve – femra ishte dominant në sektorin e infermierisë.

Nëse arrihet të krijohen mekanizma të strukturuar, të mirë organizuar dhe të motivuara, mund të krijohet klimë për të funksionuar me sukses në sektorin e shëndetësisë primare dhe emergjente edhe në një luftë tmerrësisht të pa barabartë.

**Fjalët kyçe:** Sistemi shëndetësor, infermier, mjek, ambulancë, luftë.



## **Roli i infermiereve gjatë luftës në Kosovë dhe pas periudhës së luftës**

Resmije Saipi

Infermieret përfaqësojnë popullatën më e madhe shëndetësore, dhe rrjedhimisht janë shtylla e sistemit të kujdesit shëndetësor. Infermieret janë individë profesionistë, profesionalë dhe human të cilët në sfida të ndryshme u përgjigjen me zgjidhjet më të mira në çdo situatë.

Infermiere në komunitet përfaqëson shtyllën e sistemit të kujdesit shëndetësor, i cili së bashku me profilet të tjera shëndetësore, përbënë një pjesë integrale të sistemit të kujdesit shëndetësor. Kujdesi shëndetësor është i organizuar, sistematik, i vazhdueshëm, i strukturuar dhe ka nevojë për t'iu përgjigjur nevojave specifike të çdo individi. Infermierët punojnë në fushën e promovimit të shëndetit, parandalimit e sëmundjeve, trajtimin dhe rehabilitimin. Pacientët e tyre janë të gjithë popullatat, fëmijët, gratë, të rriturit dhe të moshuarit. Ata punojnë në vende shumë të ndryshme - nga patronazhi deri në njësitë e kujdesit intensiv, nganjëherë vetë, ndonjëherë në ekip, dhe nganjëherë ndihmojnë mjekët.

Numri më i madh i infermierëve është i angazhuar në dhënien e ndihmës infermierore, disa prej tyre janë të angazhuar për organizim dhe disa për mësim dhe ligjërime. Ato ndihmojnë pacientët për të lehtësuar, zgjidhur dhe përballuar problemet që kanë për shkak të sëmundjes, mënyrën e trajtimit dhe ndarjes nga familjet.

Shumë sëmundje kërkojnë një ndryshim në stilin e jetës dhe aplikimin e aftësive të reja të jetës, kështu që motrat medicinale duhet gjithashtu të përgatiten e të mësojnë mënyra të reja të jetës dhe të përshtaten me situatën e re. Infermierët duhet të jenë emocionalisht të qetë dhe të qëndrueshëm në mënyrë që t'i kuptojnë dhe të merren me vuajtjet njerëzore, problemet shëndetësore dhe standardet etike.

Komunikimi i mirë, durimi, ndjeshmëria ndaj problemeve njerëzore që janë pjesë përbërëse e procesit të çdo infermiere, janë të nevojshme për të krijuar një marrëdhënie besimi. Infermierët duhet të jenë në gjendje të kuptojnë ndjenjat e pacientit në një situatë të caktuar.

Duhet të jenë të kujdesshme, të gatshëm të pranojnë përgjegjësinë, me vetëdije dhe në mënyrë kritike, për të zbatuar atë që është përshkruar dhe për të njohur kur duhet të konsultohet me të tjerët. Organizata Ndërkombëtare e Infermiereve dhe Komiteti Evropian i Infermierisë, bëjnë një rekomandim për edukimin e infermierëve.

Meqenëse lufta është e imponuar dhe e paparashikueshme, ajo tashmë e ka bërë situatën të vështirë edhe më dramatike. Të gjitha burimet njerëzore, të gjitha profilet, ishin të motivuara, dhe në mesin e tyre punonjësit e kujdesit shëndetësor morën një rol edhe më të rëndësishëm. Ekipet mjekësore u formuan nga profesionistë shëndetësorë të të gjitha profileve.

Lufta sjell situata të paparashikuara, kështu që ka pasur situata të panumërta kur mjeku nuk ishte afër. Pastaj infermierët duhej të tregonin të gjithë ekspertizën e tyre dhe të gjejnë zgjidhjet më të mira në çdo situatë. Rregullimi i situatës së sapokrijuar dhe gjetja e zgjidhjeve më pak të dhimbshme për të reduktuar problemet aktuale.

Gjatë luftës, infermierët nuk ka vetëm një rol mjekësor, por një rol shumë kompleks që përfshin gjithashtu probleme të një natyre sociale. Kujdesi për luftëtarët, të plagosurit, të paaftët, fëmijët, gratë, të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuara që janë pjesë përbërëse e profesionit të tyre. Sigurisht, gjatë luftës, roli parësor është të ndihmojë vijën e parë të frontit ku jeta e një infermieri është në një rrezik të barabartë, nëse jo më të madh, sesa vetë luftëtarët.

Rezultatet: Në mënyrë që të vijnë dhe të tregojnë në një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur për të arritur tek personat e plagosur dhe të lënduar, pa i kushtuar vëmendje ekspozimit ndaj zjarrit direkt të armikut, infermierja po përpiqet të sigurojë ndihmë optimale për të plagosurit në kohën më të shkurtër të mundshme. Ajo ka rëndësi të veçantë gjatë viktimave masive dhe në mungesë të mjekut. Jeta e saj është në rrezik të vazhdueshëm. Shumë prej tyre u plagosën gjatë luftës, mbetën me aftësi të kufizuara dhe disa paguan me jetën e tyre. Gjatë luftës, kishte më shumë se 2,000 punonjës shëndetësorë aktiv. Një shumicë të madhe ishin profesionistë shëndetësorë me arsim të mesëm. Në këtë rajon, u vranë 4 punonjës shëndetësorë me shkollë të mesme mjekësore, dhe tre mjekë.

Pas luftës, rëndësia e infermierëve në kujdesin e popullatës është edhe më e madhe. Problemet e vazhdueshme shëndetësore, pasojat e luftës së ashpër dhe kushtet e rënda të pasluftës, kërkojnë që njohuritë

profesionale të përmirësohen. Përveç shkollës së përfunduar, edukimi zhvillohet vazhdimisht përmes seminareve, kurseve dhe kongreseve. Ekipi i ekspertëve i emëruar nga ministrinë për edukimin e infermierëve synon të përgadis një program mësimor, i cili paraqet planin dhe programin e kujdesit shëndetësor. Karakteristikat janë origjinale dhe gjithëpërfshirëse, bazuar në pjesën konceptuale të OBSH. Ai përbëhet nga informata për shëndetin, sëmundjet, si dhe kushtet e emergjencës dhe të urgjencës dhe paraqet një udhëzues për edukimin e mëtejshëm në mënyrë që motrat medicinale të fitojnë njohuri dhe përvoja të reja.

Metodologjia: Infermierët kanë të drejtën dhe detyrimin e zhvillimit profesional duke rinovuar vazhdimisht njohuritë e fituara dhe duke fituar njohuri dhe shkathtësi të reja në përputhje me arritjet më të fundit në fushën e infermierisë.

Detyrat e një infermiere janë: aplikimi i të gjitha njohurive në dispozicion në fushën e infermierisë bazuar në një kuptim shkencor të strukturës, funksioneve fiziologjike dhe sjelljes së njerëzve të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe marrëdhëniet midis statusit shëndetësor të njeriut dhe mjedisit të tij fizik dhe social; aplikimi i metodave të zgjidhjes në zbatimin e kujdesit shëndetësor që kërkojnë aftësi analitike të qasjes kritike; zbatimi i kujdesit shëndetësorë sipas planit të përcaktuar; zbatimin, kryerjen dhe regjistrimin nga mjeku i terapisë së odrinuar; raportimin në kohë të një mjeku në rast të komplikimeve; kryerjen e procedurave në fushën e mbrojtjes së shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve; kryerjen e dokumentacionit të motrës për të regjistruar të gjitha procedurat e kryera gjatë 24 orëve; qasje në procedurën e reanimacionit në mungesë të mjekut; mbajtje i sekrete profesionale; respektimi i të

drejtave të pacientëve; respektimi i kodit të etikës së infermierëve; respektimi i parimeve fetare të pacientit; problemet shëndetësore mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në rezultatin e shumë problemeve jo mjekësore.

Reforma shëndetësore kërkon një koncept të ri që përfshin edukimin e infermierëve, autonominë e tyre, detyrat dhe përgjegjësinë më të madhe dhe barazinë në ekipin multidisiplinar.

Zhvillimi i kurrikulave do të mundësojë përmirësim të vazhdueshëm në mënyrë që infermierja të mund të përgjigjet në mënyrë profesionale, të shpejtë dhe efikase për të gjitha problemet dhe çështjet që sjell një shoqëri moderne.

**Fjalët kyçe:** infermier, luftë, shëndetësi, edukim.

## *Abstraktet e punimeve*



## **Mos zbatimi i rekomandimeve të modifikimit të jetesës në mesin e pacientëve me Diabet Melitus Tip 2**

Shukrije Baruti, Majlinda Bajraktari, Drita Avdiu

**Hyrje:** Fokusi kryesor i këtij studimi ishte të kuptojmë se sa i ndjekin rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë për dietë dhe ushtrime pacientët me diabet në një fshat të rrethit të Mitrovicës.

**Qëllimi:** Hulumtimi është fokusuar në 80 pacientë me diabet të cilët kanë ardhur për vizitë në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në fshatin Koshtovë.

**Metodologjia:** Përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë të qëllimshme. Instrumenti i përdorur për këtë hulumtim është pyetësor i cili përmban 25 pyetje lidhur me zbatimin e rekomandimeve për ndryshimin e stilit të jetës, dieta dhe ushtrimet. Pyetjet janë të tipit të mbyllur, të dhënat janë analizuar me Pakon Statistikore të Shkencave Sociale - SPSS 21, ku janë përdorur analiza deskriptive dhe korelacioni.



**Rezultatet:** Në këtë punim u supozua se pacientët me diabet nuk i zbatojnë rekomandimet për ndryshimin e stilit të jetës, me ç'rast hipoteza nuk vërtetohet pasi përafërsisht 65.9% e respondentëve praktikojnë ushtrime të lehta, përderisa 34% e tyre nuk praktikojnë. Nga pacientët me diabet 35.1% ishin meshkuj dhe 64.9% ishin femra. Modifikime diete praktikojnë përafërsisht 75% e pacientëve, ku 11.2% e tyre praktikojnë dietë me fibra, dietën me yndyrë me pak kalori e praktikojnë 47.8% e tyre, ndërkaq dietën me fruta dhe me perime vetëm 15.9% e pacientëve. Pacientët me diabet të cilët raportojnë se merren me aktivitete, vetëm 15.1% e tyre ushtrojnë një herë në ditë, 39.5% një herë në javë, dhe 11.3% e tyre së paku tri herë në javë. Analiza korelacionale na tregon se ekziston ndërlidhje signifikante pozitive në mes të moshës dhe ndjekjes së rekomandimeve për ndonjë formë të ushtrimeve, poashtu edhe në mes moshës dhe ndjekjes së rekomandimeve të ndonjë diete. Korelacion signifikant pozitiv ekziston edhe në mes të nivelit arsimor dhe kohëzgjatjes së ushtrimeve.

**Konkluzione:** Duke u bazuar në të gjeturat e hulumtimit kuptojmë se pacientët me Diabet Melitus në fshatin Koshtovë i zbatojnë rekomandimet për modifikimet e dietës dhe ushtrimet për menaxhimin e sëmundjes. Por gjithashtu konkludojmë se sa më e madhe moshja e pacientëve edhe ndjekja e rekomandimeve për dietë dhe ushtrime është më e madhe.

**Fjalët kyçe:** Diabet, zbatim, rekomandime, dietë, ushtrime

## **Ndikimi i obezitetit në sëmundjet kardiovaskulare**

Shpejtim Rramanaj, Kadri Jusufi, Valentina Gashi

**Qëllimi** kryesor i studimit është lidhshmëria e mundshme ndërmjet obezitetit dhe sëmundjeve të sistemit kardiovaskular (SKV) në komunën e Prizrenit. Objektivat: lidhshmëria ndërmjet faktorëve social-ekonomik dhe SKV. Analizimi i kushteve socio mjekësore, indeksi i masës trupore, shprehitë e të ushqyerit dhe faktorët tjerë si: gjinia, moshë, ngarkesat psikike dhe faktorë tjerë të pamodifikuar që ndikojnë në paraqitjen e obezitetit.

**Metodologjia**, për realizimin e punimit është përdorur metoda e hulumtimit që është realizuar përmes intervistës (me anë të pyetësorit). Në këtë studim janë përfshirë 300 persona obezë me probleme kardiovaskulare, të moshave mbi 20 vjeç, nga të dy gjinitë. Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës kohore Mars - Qershor 2018, në bashkëpunim me Spitalin Rajonal të Prizrenit, QKMF dhe Qendrat e Mjeksisë Familjare në Prizren. Përpunimi statistikor është realizuar me programin SPSS 22.

**Rezultatet** e hulumtimit tregojnë se moshë më e prekur në këtë hulumtim është mes 51-65 vjeç me 46%, gjinia femrore me 61%, vendbanimet urbane me rreth 58.7%. 51.7% e pjesëmarrësve ushqehen dy herë në ditë, 83.3% deklarojnë se hanë mëngjes, 91.3% konsumojnë shujtat në orarë, 56.3% nuk konsumojnë ushqim pas orës 6 të darkës, 34.3% konsumojnë ushqim më shumë se e kanë planifikuar. 36.9% hanë nga mërzitja ose stresi, vetëm 43.8% i kushtojnë vëmendje asaj që hanë, 49.2% konsumojnë yndyrna dhe

sheqerna. 73.3% frekuentojnë restorante të ushqimit të shpejtë, 49.3% konsumojnë pije të gazuara, 63.6% përdorin mikrovalë, 68.7% ushqehen duke shikuar televizor. 70% pajtohen se ushqimi ndikon në mundësinë e marrjes së sëmundjeve të zemrës apo kancerit, 77.65% vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare, përqindja më e lartë e sëmundjeve kardiovaskulare me 79.2% është gjetur te grupi i femrave. 75% mendojnë se aktiviteti fizik është i rëndësishëm për të humbur peshë dhe 64.25% janë deklaruar se nuk kanë provuar ndonjë program për humbje peshe apo dieta.

**Përfundimet** - Faktorët individual me ndikim të madh në prevalencën e Obezitetit janë ushqimi jo i shëndetshëm (përmbajtja, sasia, orari i shujtave) dhe mungesa e aktiviteteve fizike, pastaj faktorët tjerë social-ekonomikë si niveli i edukimit, profesioni dhe faktorët e lidhur me stilin e jetesës. Ngarkesa e pranisë të sëmundjes kardiovaskulare tek personat obez mund të pakësohet me anë të diagnostikimit të hershëm, rehabilitimit dhe vazhdimësisë së parandalimit, duke përfshirë kurdoherë këshillimin e përshtatshëm për mënyrat e jetesës së shëndetshme.

**Fjalët kyçe:** Obeziteti, sëmundjet e zemrës, ushqimi, aktiviteti fizik.

## **Ofrimi i kujdesit paliativ nga Kujdesi primar dhe atij terciar**

Shahadije Raka

**Hyrje:** Gjendja e shërbimit të kujdesit paliativ në Kosovë nuk është e mirë. Shërbimi i kujdesit paliativ ofrohet kryesisht nga ekipet e kujdesit primar dhe poashtu në Klinikën e Onkologjisë, Neurologjisë dhe Hematologjisë në QKUK (me qëndrim ditor, apo disa ditor), kryesisht për sëmundjet malinje.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i nevojave dhe problemeve të pacientëve në kujdesin paliativ në Kosovë për ruajtjen e kualitetit të jetës në aspektin fizik, mental, shpirtëror dhe social.

**Metodologjia:** Ky hulumtim ka qasje kuantitative. Mostra është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme me një numër prej 250 pacientë të cilët kanë marrë shërbime të kujdesit paliativ. Mbledhja e të dhënave është bërë duke përdorur pyetësin PNPC – Problems and Needs in Palliative Care.

**Rezultatet:** Më shumë se 50% e të intervistuarve kanë probleme të ndryshme dhe nevojë për kujdes profesional në fushën e aktiviteteve ditore, simptomave fizike, autonomia/pavarësisë individuale, qështje të problemeve sociale, problemeve psikologjike, problemeve shpirtërore, dhe problemeve të ndryshme të shkaktuara si pasojë e sëmundjes që duhet t'iu ofrohet nga punëtorët shëndetësor.

**Përfundimi:** Pacientët në kujdesin paliativ kanë probleme dhe nevoja në shumë fusha si ato fizike, psiko- sociale, shpirtërore, financiare, informative e të tjera, kanë nevojë për përkujdesje profesionale

shëndetësore. Në Kosovë nuk është i organizuar mirë kujdesi paliativ dhe mungojnë ekipet e specializuara për ofrimin e këtij shërbimi në institucionet publike, përveç atyre që ofrohen në Klinikën e Onkologjisë dhe nga disa ekupe të kujdesit primar shëndetësor.

**Fjalët kyçe:** Kujdesi paliativ, pacientë, nevoja, probleme.

## **Njohurit mbi efektet e dëmshme të pirjes aktive dhe pasive të duhanit tek adoleshentët**

Rukije Hajdari - Pllana

**Qëllimi** i këtij hulumtimi është identifikimi i njohurive mbi efektet e dëmshme të pirjes aktive dhe pasive të duhanit tek adoleshent. Vlerësimi mbi duhanpirjen: sa e pinë duhanin adoleshentët dhe në cilat ambiente e pinë, sa e konsumojnë duhanpijen prindërit e tyre.

**Metodologjia** e këtij hulumtimi është kuantitative duke përdorur teknikën e një pyetsori të standardizuar. Duke pasur parasysh kontekstin e zhvillimit dhe njëkohësisht relevancën e temës, mënyrën e zhvillimit të saj dhe qasjen ndaj problemit, metoda më e përafërt që do të përdoret për të ardhur deri tek rezultatet e pritshme është metoda kuantitative e hulumtimit. Aspekti final i metodologjisë do të përmbajë kryesisht organizimin, analizimin, transformimin, krahasimin dhe interpretimin e të dhënave dhe rezultateve të nxjerra. Instrumenti i përdorur është i standardizuar, qëllimi i së cilit është të vlerësoj njohuritë mbi efektet e dëmshme të pirjes aktive dhe pasive të duhanit tek adoleshentët. Mostra është e rastit, pjesë e këtij hulumtimi janë 200 nxënës të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Dr Xheladin Deda" dhe Gjimnazit në Komunën e Mitrovicës. Moshë e tyre është 15- 18 vjet.

**Rezultatet** e këtij hulumtimi tregojnë se adoleshent kanë shumë njohuri për dëmet e duhanpirjes aktive dhe pasive të duhanit, ku 60% prej tyre janë përgjigjur se kanë shumë njohuri, 38% janë përgjigjur se kanë pak njohuri. Në hulumtim, përqindja më e lartë e të

anketuarëve kanë qenë femra 64% dhe meshkuj 36%. Të anketuarit korrespondojnë me një përqindje të lartë si banorë të qytetit me 59 % e tyre. Niveli arsimor i prindërve të respondentëve, prej të cilëve 8% janë me arsimim fillor, 55% me arsimim të mesëm dhe 37% me arsimim të lartë.

**Konkluzionet** në bazë të hulumtimit konkludojmë se përdorimi i duhanit është shumë i përhapur dhe se kontrolli i konsumimit të duhanit në vendet publike, sidomos në një vend si Kosova, është mjaft i vështirë. Në hulumtim dëshmohet se meshkujt më shumë janë duhapirës aktiv se sa femrat. Përforcimi i legjislacionit ekzistues, duke krijuar hapësira publike 100% pa duhan, si dhe inspektimet e rregullta për t'u siguruar se Ligji për Kontrollin e Duhanit po zbatohet nga të gjithë. Respondent që nuk pajtohen për pirjen e duhanit nga prindërit e tyre janë 94% dhe ata të cilët pajtohen janë vetëm 6% e respondentëve.

**Fjalët kyçe:** Adoleshentët, duhanpirja aktive, pasive, dëmet, sëmundja

## **Kënaqshmëria e pacientëve me shërbimin infermieror në departamentin internistik në Gjilan**

Feride Morina

**Hyrje:** Kënaqësia e pacientit me kujdesin infermieror është e njohur për të parashikuar rezultatet e pacientit. Kujdesi infermieror ofrohet nga infermieret që janë grupi më i madh i punëtorëve shëndetsorë në çdo spital e që përcaktonë cilësinë e përgjithëshme të kujdesit të ofruar.

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëllim vlerësimin e kënaqshmërisë së pacientëve me kujdesin infermieror duke përdorur pyetësonin kënaqshmëria e pacientit me shkallen e kujdesit infermieror (PSNC), e i cili u zhvillua ne bazë të Modeli i ndërveprimit të sjelljes shëndetësore të klientit.

**Metodologjia:** Në këtë studim deskriptiv përshkrues kanë qenë të përfshirë 132 respondentë të shtrirë në pesë reparte të departamentit internistik të Spitalit të Gjilanit, ku 54% ishin femra dhe 46% ishin meshkuj.

**Rezultatet:** Gjetjet e këtij studimi zbuluam se pacientët vlerësonin kujdesin infermieror në nivel të moderuar të kënaqshmërisë./M 3.27 , DS 0.73/. Shumica e pacintëve ishin shumë të kënaqur për nga aspekti i kujdesit infermieror që përbënë: “Respektin”, ”kujdesin”, “sigurinë”. Pacientët ishin më pak të kënaqur në aspektin e informacioneve që marrin nga infermierët për shëndetin e tyre si dhe informacionet që marrin nga infermierët për ecurinë planin nga



infirmierët. Nuk kishte dallime të konsiderueshme në mes të gjinive. Sa i përket reparteve kishte dallime të konsiderueshme, kënaqshmëria më madhe ishte në repartin e infektivës 67%, mandej atë të Dializës 66%, Internës 59%, Neurologjisë 57%, dhe Pulmologjisë 55%.

**Konkluzione:** Përcaktimi i nivelit të kënaqësisë së pacientit dhe faktorëve kontribues mund të ndihmoj infirmierët në përmirësimin e kujdesit infirmieror. Rekomandojmë edukimin e vazhduar të infirmierisë në mënyrë që të kenë sa më shumë njohuri teorike dhe shkathësi praktike dhe që të jenë të aftë të japin informacione që kërkojnë pacientët rreth gjendjes së tyre shëndetësore, këshilla të ndryshme që janë edhe kompetencë e infirmierëve, kjo do ndikonte në ngritjen e kënaqësisë së pacientit.

**Fjale kyçe:** Vlerësimi, kënaqshmëria e pacientit, kujdesi, infirmier,

## **Cilësia e shërbimeve tek pacientët në Repartin e Hemodializës në QKUK**

Fatmire Ahmeti, Lirije Beqiri, Aferdita Leka

**Hyrje:** Cilësia e shërbimit është një matës për të vlerësuar se sa mirë një nivel i dhënë shërbimi përputhet me pritshmëritë e konsumatorit. Cilësia e shërbimit shëndetësor në Kosovë ende nuk ka marrë rëndësinë që e meriton, e veçanërisht në kujdesin terciar për arsye të numrit të madh të pacientëve në njerën anë dhe numrit të vogël ofruesve të kujdesit shëndetësor nga ana tjetër.

**Qëllimi** i hulumtimit është të pasqyroj cilësinë e shërbimeve shëndetësore në dializë, i parë nga këndvështrimi i pacientëve, gjithashtu të bëjë përshkrimin e dimensioneve të cilësisë, të cilat ndikojnë në pritshmërinë dhe përceptimin real të pacientëve.

**Metodologjia:** Është përdorur pyetëtori Servqual (Rater) i cili matë hendekun ndërmjet pritshm-ërive dhe përceptimeve reale të pacientëve. Analizimi i të dhënave është bërë me paketën statisti-kore SPSS 21, Word dhe Exel.

**Rezultatet** e këtij studimi treguan se përceptimet e pacientëve dhe niveli i shërbimeve të ofruara në dializë ishin më të larta se pritshmëritë e tyre. Pacientët në Dializa 1 kanë treguar se kanë pritshmëri më të larta (respektivisht 66.1250) dhe përceptime më të ulta (respektivisht 121.8542) krahasuar me pacientët në Dializa 2, të cilët kanë raportuar për pritshmëri më të ulta (respektivisht 42.8077) dhe përceptime më të larta (respektivisht 153.9600). Cilësia e shërbimit shëndetësor ndikon në kënaqshmërinë e pacientëve. Përmes analizës

së korrelacionit është matur kënaqëshmëria e pacientëve në raport me perceptimet që kanë për shërbimet që marrin. Vlera .000 e signifikancës ka treguar që ekziston një lidhje e rëndësishme në mes të perceptimeve dhe pritshmërive të pacientëve në Dializa 1. Nga ana tjetër, edhe vlera .002 e signifikancës ka treguar që ekziston një lidhje e rëndësishme në mes të perceptimeve dhe pritshmërive të pacientëve në Dializa 2.

Sipas rezultateve, pyetësi i përdorur në kuadër të këtij hulumtimi, është i besueshëm.

Vlera .934 e Cronbach's Alphas, tregon për besueshmëri të lartë të pyetësit që është përdorur për këtë hulumtim. Ofruesit e kujdesit shëndetësor duhet të kenë më shumë vëmendje për opinionet dhe komentet e pacientëve dhe të përdorin reagimet dhe sygjerimet e tyre në mënyrë që të zgjidhin problemet dhe për të përmisuar cilësinë e shërbimeve të ofruara. Rekomandohet të trajnohet stafi shëndetësor për të përmbushur nevojat emocionale dhe pritjet e pacientëve.

**Fjalet kyçe:** cilësia, shërbimi shëndetësor, dializa.

## **Shkalla e depresionit postpartal dhe kënaqësia martesore në Kosovë**

Vjollca Krasniqi – Jusufi

**Hyrje:** Lidhja në mes të kënaqësisë martesore dhe depresionit postpartal në Kosovë, ndonëse në relacion të fuqishëm, nuk është studiuar sa duhet.

**Qëllimi i punimit:** Ky punim ka për qëllim që ta sqarojë këtë raport duke dhënë përgjigje në cilësinë e marrëdhënies në çift dhe incidencës së depresionit te nënat pas lindjes.

**Metodologjia:** Punimi është realizuar ne Klinikën e Gjinekologjisë të QKUK dhe është i bazuar në një anketë për lehona, të dizajnuar në mënyrë të posaçme për të analizuar cilësinë e raportit në çift dhe shenjat eventuale të depresionit. Vlerësimi është bërë në shkallën e Edinburgut për stres postpartal dhe shkallën e satisfaksionit në martesë.

**Rezultatet:** Janë anketuar 100 lehona, mosha mesatare e të cilave ka qenë 27.87% vjet ( $SD=4.33$ ), respektivisht në mes 19 (minimale) deri 40 (maksimale) vjet. Me shenja të depresionit në shkallë të ndryshme janë gjetur 59% të të anketuarve, 1% prej të cilave me mendime suicidale. 69% e të anketuarve e kanë vlerësuar raportin e tyre në martesë si shumë të mirë, 24% si të mirë, 4% si të kënaqshëm dhe 3% si jo të mirë. Analizat e korrelacionit në mes të depresionit dhe kënaqësisë martesore ka dalë  $r=-.56$ , me  $p<.01$  ku rezulton se me rritjen e njëjës hipotezë, zvoglohet hipoteza tjetër.

**Përfundimi:** Studimi ka vërtetuar se nëse kënaqësia martesore është e ulët, depresioni postpartal është i lartë dhe e kundërta që do të thotë se nëse depresioni postpartal është i ulët, kënaqësia martesore është e lartë.

**Fjalë kyçe:** depresioni postnatal, kënaqësia martesore.

## **Vlerat profesionale në Infermieri**

Abdullah Gruda

**Qëllimi:** Qëllimi i hulumtimit të literaturës ishte përshkrimi i vlerave profesionale të infermierëve gjatë praktikimit të kujdesit infermioror.

**Metodologjia:** Hulumtimi i literaturës është bërë në bazat e të dhënave në Pubmed, CINAHL, Biomed Ovid dhe në The British Nursing Index dhe ka përfshirë periudhën kohore 2015-2019.

**Rezultatet:** Janë identifikuar gjithsej 13 studime ndërkombëtare të cilat eksploronin vlerat profesionale në infermieri. Në të gjitha studimet infermierët treguan rezultate të larta në perceptimin e vlerave profesionale. Studimet konfirmuan se infermierët në mbarë botën udhëhiqen nga vlerat e përbashkëta të cilat mund të ndryshojnë si rezultat i dallimeve kulturore, karakteristikave personale, nivelit të shkollimit dhe përvojës profesionale. Analiza e këtyre vlerave zbuloi se më të vlerësuara në mesin e infermierëve ishin konfrontimi me praktika të dyshimta ose të papërshtatshme, ruajtja e konfidencialitetit të pacientit, pranimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënies për ofrimin e shërbimit, mbrojtja e të drejtave morale dhe ligjore dhe mbrojtja e të drejtës së pacientit për privatësi. Ndërsa më pak të vlerësuara ishin altruizmi, statusi shoqëror, bindja ndaj autoritetit dhe pjesëmarrja në aktivitetet e shoqatave profesionale të infermierisë. Integrimi i vlerave profesionale në kujdesin infermioror rezulton me zvogëlimin e lodhjes emocionale dhe depersonalizimit, rritjen e suksesit personal dhe bashkëpunimit me anëtarët e ekipit të kujdesit shëndetësor. Në kundërtën mungesa e vlerave profesionale ndikon negativisht në

efektivitetin e shërbimeve infermierore, në zhvillimin dhe imazhin e profesionit si dhe në satisfaksionin e pacientëve me shërbimet e marrura.

**Përfundimi:** Infermierët ofrojnë kujdes për pacientët e tyre në dritën e vlerave profesionale të cilat i ndihmojnë infermierët të bashkohen në një kulturë dhe mison të përbashkët. Vlerat profesionale janë baza e praktikimit të profesionit dhe përdoren si udhërrëfyes për bashkëveprim me pacientët, për të zgjidhur problemet etike dhe për të marrë vendime. Meqenëse shumë mjedise shëndetësore shërbejnë edhe si vendpraktika për studentët, infermierët në këto mjedise përveç roleve tjera kanë edhe rol në transmetimin e vlerave profesionale tek studentët e infermierisë. Praktikimi i infermierëve duke u bazuar në vlera profesionale e fuqizon edhe më shumë rolin e tyre në mjediset e kujdesit shëndetësor.

**Fjalët kyçe:** Infermier, vlera profesionale, kujdesi infermieror, fuqizimi.

## **Kujdesi shtëpiak te pacientët e palëvizëshëm në kujdesin parësor shëndetësor në Ferizaj**

Selim Bega, Behrije Halilaj-Vishi, Ali Shaqiri

**Hyrje:** Kujdesi shtëpiak është sigurimi i shërbimeve shëndetësore dhe i pajisjeve mjekësore për pacientët në vendin e tyre të banimit, edukimin, parandalimin, diagnostifikimin, trajtimin, si dhe qetësimin e sëmundjes dhe rehabilitimin përmes ekipit të kujdesit shtëpiak në përbërje nga; mjeku, infermieri, psikologu, terapisti, fizioterapisti, asistenti social, etj. Roli i infermierit është kryesor pasi që kalon kohën më të madhe duke ofruar shërbime.

**Qëllimi i hulumtimit:** Është të pasqyroj punën e bërë nga Kujdesi Shëndetësor në Kujdesin Parësor Shëndetësor në Ferizaj dhe të masë nivelin e kënaqshmërisë së këtyre pacientëve që marrin shërbimet nga këto ekipe.

**Metoda:** Është përdorur pyetësi i strukturuar për satisfaksion të pacientëve. Numri i respondentëve në këtë hulumtim ishte 72, grup e caktuar ishin pacientët e të gjitha moshave që shfrytzojnë shërbimet në shtëpi nga Kujdesi Shëndetësor.

**Rezultatet:** Nga rezultatet e fituara në hulumtim, shkaktarët më të shpesht të paafësisë së këtyre pacientëve janë sëmundjet ICV (Insulticerebrovaskular) dhe CA (karcinomet) me 19% ose 14 respondent, respektivisht 18% ose 13 respondent kurse pasojnë rastet post operatore dhe rastet geriatrike (probleme të pleqërisë) me nga 7 respondent ose nga 10%. Sipas profesionit ishin; pensionist 42 ose 58%, amvisë 9 ose 12%, puntorë 6 ose 8.3%, të papunë 6 ose 7% dhe



persona të hendikepuar 6 ose 7%. Nga matja e opinioneve shumica e pacientëve ishin shumë të kënaqur me konfidencialitetin dhe mirsjelljen e personelit në masën 96% ose 69 respondent, dhe me shërbimet e kësaj qendre si shumë të kënaqur ishin 90% ose 65 respondent, të kënaqur ishin 6 respondent ose 8%. Në pyetjen se sa ishin të kënaqur me furnizim me barna dhe me material tjetër të nevojshëm nga institucioni shumë të kënaqur ishin 12 respondent ose 17%, të kënaqur ishin 24 respondent ose 33%, të pakënaqur ishin 23 respondent ose 32%, dhe asnjë ishin 13 respondent ose 18%. Në pyetjen se sa kanë përparuar shërbimet në tri vitet e fundit; 33 respondent ose 46% mendojnë se kanë përparuar, kurse mendojnë se kanë mbetur të njëjta 34 respondent ose 47%.

**Përfundimi:** Nga rezultatet e hulumtimit mund të konkludojm se shumica e respondentëve kanë besim në punën, aftësitë dhe shërbimet e personelit shëndetsorë dhe kjo bazohet në pyetjen "në rast të sëmundjes së ndonjë të afermi tuaj a do ti kishit preferuar vizitë në këtë qendër", 67 respondent ose 94% ishin përgjigjur pozitivisht.

**Fjalët kyçe:** Kujdesi shtëpiak, ekipi i kujdesit shtëpiak, infermieri, përkujdesja.

## **Vlerësimi i njohurive të prindërve, edukatorëve dhe mësimit në shkollë për faktorët e rrezikut nga sëmundjet ngjitëse në komunën e Ferizajt**

Mimoza Emini

**Hyrje:** Vlerësimi i faktorëve të rrezikut në sëmundjet ngjitëse është pjesë e rëndësishme në shëndetin publik dhe i institucioneve të tjera shëndetsore si dhe të gjitha institucioneve tjera relevante. Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse është mënyra kryesore e luftës ndaj këtyre sëmundjeve.

**Qëllimi** i punimit ishte të bëhet vlerësimi i njohurive të prindërve, edukatorëve dhe i mësimit për faktorët e rrezikut që ndikojnë në paraqitjen e sëmundjeve ngjitëse.

**Metodologjia:** Është përdorur pyetësi i strukturuar në këtë hulumtim dhe për punimin e temës për vlerësimin e faktorëve për sëmundje ngjitëse janë përzgjedhur prindërit, qerdhet dhe shkollat fillore dhe ato të mesme në qytet dhe në fshat.

**Rezultatet:** Në hulumtim janë përfshirë 218 respondent, 61 prindër, 52 edukatorë si dhe 105 mësimit. Sëmundjet që i prekin më së shpeshti fëmijët sipas prindërve të tyre janë: 41.0% fytë (laringjite, faringjite, anginë lakunare), 36.1% gripi, 19.7% temperaturë, 9.8% diare (barkqitje) dhe 3.3% bronkopneumoni. Sipas edukatorëve, fëmijët në çerdhe më së shpeshti sëmurën nga ftohja me 80.8%, pastaj kolla me 78.8%, temperatura 65.4%, barkqitja 15.4%, vjellja 5.8% dhe më së rralli nga infeksionet e veshit me 3.8%. Rruga më e

shpeshtë e përhapjes së këtyre sëmundjeve sipas edukatoreve është teshtitja me 84.6%, pastaj kollitja me 82.7%, duart me 34.6% dhe rrugët tjera me 3.8%. Sipas mësimit në shkollë më së shpeshti sëmurën nga ftohja me 90.5%, pastaj kollja me 73.3%, temperatura 52.4%, barkqitja 21.9%, vjellja 8.6% dhe më së rralli nga infeksionet e veshit me 2.9%. Rruga më e shpeshtë e përhapjes së këtyre sëmundjeve sipas mësimit është teshtitja me 75.2%, pastaj kollitja me 72.4%, duart me 59.0% dhe rrugë tjera me 5.7%.

**Konkludimi:** Në bazë të këtij hulumtimi ne mundë të konkludojmë se njohurit e prindërve, edukatorëve dhe mësimit për faktorët e sëmundjeve ngjitëse janë akoma të mangëta. Shkollat e qytetit nuk kanë shumë dallim nga ato fshatit. Ka akoma një infrastrukturë të dobët dhe e nyje sanitare jo shumë të zhvilluara, përveq kësaj që duhet ti jepet prioritet duhet theksuar se duhet të bëhen trajnime, ligjërata, tribuna dhe në përgjithësi të bëhet promovim dhe edukim shëndetësor për faktorët e rrezikut të sëmundjeve ngjitëse.

**Fjalët kyçe:** Faktorët e rrezikut, sëmundjet ngjitëse, parandalimi, edukimi

# *Autorët*

**A**

- 
1. Abdullah Gruda
  2. Aferdita Leka
  3. Ali Shaqiri

**B**

- 
4. Behrije Halilaj-Vishi

**D**

- 
5. Drita Avdiu

**F**

- 
6. Fatmire Ahmeti
  7. Feride Morina

**H**

- 
8. Hidajete Krasniqi

**K**

- 
9. Kadri Jusufi

**L**

- 
10. Lirije Beqiri

**M**

- 
11. Majlinda Bajraktari
  12. Mimoza Emini
  13. Musë Baftiu

**R**

- 
14. Resmije Saipi
  15. Rukije Hajdari - Pllana

**S**

- 
16. Shahadije Raka
  17. Shpejtim Rramanaj
  18. Shukrije Baruti
  19. Selim Bega


**V**

- 
20. Valentina Gashi
  21. Vjollca Krasniqi –  
Jusufi

**X**

- 
22. Xhemajl Dugolli

## Përkrahësit e Konferencës:



[www.oik-ks.org](http://www.oik-ks.org); [info@oik-ks.org](mailto:info@oik-ks.org)

ISBN 978-9951-8984-0-9

